



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2020

**PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 11.09.2020)*

*Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.*

*Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 14:00 dhe mbaroi në orën 14:23.*

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Naureda Llagami (kryetare)*
- 2. Maksim Qoku (zëvendëskryetar)*
- 3. Medi Bici (anëtar)*
- 4. Fatmira Luli (anëtare)*
- 5. Brunilda Kadi (anëtare)*
- 6. Dritan Hallunaj (anëtar)*
- 7. Ilir Toska (anëtar)*
- 8. Alban Toro (anëtar)*
- 9. Brikena Ukperaj (anëtar)*
- 10. Erjon Muharremaj (anëtar)*
- 11. Marçela Shehu (anëtare)*

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*

**Mbledhje e Këshillit të Lartë Gjyqësor**  
**Tiranë, më 11.09.2020 – ora 14:00**

3. *Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
4. *Baisa Sefa, Këshilltare pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
5. *Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
6. *Pjesë nga stafi i administratës së KLGJ-së.*
7. *Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID.*

## **RENDI I DITËS:**

1. Shqyrtimi i projektvendimeve “Për zbatimin e vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr.30, datë 14.02.2019, “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”, në lidhje me nevojat e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin”; “Për miratimin e listës së gjyqtarëve që do të caktohen për të gjykuar çështje gjyqësore urgjente në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kurbin”.

***Naureda Llagami:*** Përshëndetje të gjithë anëtarëve!

Duke qenë se jemi të gjithë të pranishëm, fillojmë mbledhjen e radhës të Këshillit të Lartë Gjyqësor të datës 11.09.2020.

Siç jeni në dijeni, në rendin e ditës është vënë një pikë për të cilën kërkohet vendimmarrje nga ana e Këshillit. Bëhet fjalë për dy projekt-akte: Projektvendimi i parë ka të bëjë me “Për zbatimin e vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr.30, datë 14.02.2019, “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”, në lidhje me nevojat e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin” dhe projektvendimi tjetër ka të bëjë me miratimin e listës së gjyqtarëve që do të caktohen për të gjykuar çështje gjyqësore urgjente në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kurbin.

Më lejoni t’ju them se siç ju ka bërë me dije edhe kancelari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, të gjithë gjyqtarët e kësaj gjykate janë diagnostikuar me COVID-19, çka bën të pamundur shqyrtimin nga kjo gjykatë të çështjeve urgjente që mund të paraqiteshin në ditën në vijim. Kështu, në kushtet e mungesës në detyrë për një kohë të pacaktuar të të gjithë gjyqtarëve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, Komisioni i

Zhvillimit të Karrierës i ka propozuar Këshillit projekt-aktet e mësipërme. Për më shumë detaje, dëshiroj t'ia jap fjalën kryetarit të këtij Komisioni, zotit Ilir Toska.

***Ilir Toska:*** Faleminderit!

Atëherë, siç tha edhe kryetarja, për të shkak të situatës së krijuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kurbin, kur të gjithë gjyqtarët e kësaj gjykate (pra 3 gjyqtarë) janë diagnostikuar me COVID-19 dhe në situatën kur në këtë gjykatë mund të ketë çështje urgjente që do duhet të shqyrtohen brenda afateve të caktuara nga Kodet e Procedurave Penale dhe Civile, jemi të detyruar të zbatojmë Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr.30, datë 14.02.2019, “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”, por tashmë duke gjetur një rregullim paksa më të ndryshëm sa i përket caktimit të gjyqtarit për të zgjidhur sa më shpejt në kohë nevojat që mund të ketë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin për periudhën në vijim, deri në shërimin e të paktën një prej gjyqtarëve të kësaj gjykate dhe paraqitjen e tij në detyrë për të zgjidhur çështjet urgjente në këtë gjykatë.

Komisioni ka marrë shkas për përgatitjen e projektvendimeve, siç tha edhe Kryetarja, nga njoftimi që bëri kancelari i gjykatës ditën e djeshme në mesditë, pasdreke. Kemi përgatitur projekt-aktet. Sipas projektvendimit të parë, në pikën 1 të projektvendimit është përcaktuar rregulli sipas të cilit do duhet të zgjidhim nevojat e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, në lidhje me çështjet gjyqësore urgjente, qoftë në lëndë penale ashtu edhe në lëndë civile, për periudhën deri kur do të paraqitet në detyrë një gjyqtar i kësaj gjykate, ndërsa paraprakisht kjo periudhë është përcaktuar deri më datë 30.09.2020, duke mbajtur në konsideratë për këtë një numër ditësh të nevojshme për trajtimin e sëmundjes dhe karantinimin e gjyqtarëve të prekur nga COVID-19.

Sa i përket çështjeve gjyqësore urgjente, si të tilla janë ato që përcakton shkronja “c”, neni 2, i Ligjit nr. 98/2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, pra ato çështje gjyqësore për të cilat dispozitat procedurale parashikojnë se duhet të vendoset jo më vonë se 14 ditë nga regjistrimi në gjykatë, ku përfshihen kërkesa të fazës së hetimit paraprak, kërkesa të kompetencës së gjyqtarit të seancës paraprake, kërkesa për sigurim padie apo lëshim urdhër mbrojtje, etj.

Duhet përmendur se projektvendimi ka parashikuar një afat me kalimin e të cilit rregullat e këtij vendimi nuk do të zbatohen, pikërisht deri në momentin e paraqitjes në detyrë të një prej gjyqtarëve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin. Gjithsesi, për efekt planifikimi, në projektvendim është përcaktuar fillimisht rregullimi i situatës për çështjet gjyqësore që do të regjistrohen deri më datë 30.09.2020. Një përcaktim i tillë nuk do të pengojë Këshillin të shtrijë në kohë efektet e zbatimit të tij në situatën kur deri në këtë datë të mos paraqitet në detyrë asnjë nga gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin. Në këtë rast Këshilli do të duhet të vendosë për vijim e zbatimit të rregullave sipas të këtij projektvendimi edhe për një periudhë tjetër, duke bërë planifikimin përkatës të gjyqtarëve që do të caktohet për të gjykuar në këtë gjykatë.

Rregulli i përcaktuar sipas shkronjës “a”, pika 1, të projektvendimit të propozuar, konsiston në krijimin, mbi bazën e shortit, të një liste gjyqtarësh nga gjykata të tjera më të afërta të rretheve gjyqësore me Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kurbin, të cilët do të caktohen për të gjykuar në këtë gjykatë çështje gjyqësore urgjente, ku secili gjyqtar i listës caktohet automatikisht për çështje të regjistruara për çdo periudhë dyditore, brenda periudhës deri më datë 30.09.2020, pa qenë e nevojshme paraqitja nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin të kërkesave për caktim gjyqtari për këtë kategori çështjesh. Sipas projektvendimit, Këshilli duhet të miratojë menjëherë, mbi bazën e shortit, listën e gjyqtarëve, listë e cila, nëse do të jete e nevojshme, duhet të përditësohet nga Këshilli.

Ndërkohë, në shkronjën “b” të kësaj pike të projektvendimit të propozuar, me qëllim për të rregulluar situata që mund të lindin për shkak të mosparaqitjes në detyrë, për periudhën përkatës, të gjyqtarit të listës së miratuar apo kur ai ka papajtueshmëri për ushtrimin e funksionit në çështje gjyqësore të veçanta, është parashikuar se trupi gjykues në këto raste formohet me gjyqtarin që gjendet i renditur më pas në listë. Në një rast të tillë, në këtë rregullim të projektvendimit të propozuar, është parashikuar edhe se gjyqtari i gjendur në situatën sipas kësaj shkronje, kur është e mundur, përmbush detyrën në periudhën dyditore pasuese.

Në pikën 2 të projektvendimit të propozuar përcaktohet se Kancelari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin merr masa për njoftimin në kohë të gjyqtarit të caktuar apo atij zëvendësues, sipas pikës 1 të këtij vendimi, duke patur parasysh për këtë mungesën e drejtuesit të gjykatës, por edhe të gjyqtarëve të tjerë të saj.

Në pikën 3 të projektvendimit të propozuar përcaktohet që një kopje e vendimit t'iu njoftohet, jo vetëm Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, për edhe Gjykatave të Rretheve Gjyqësore Tiranë, Krujë dhe Lezhë, për shkak se rregullimet e tij angazhojnë gjyqtarët e këtyre gjykatave.

Së fundi, në projektvendim parashikohet hyrja në fuqi e vendimit, duke përcaktuar se ai hyn në fuqi menjëherë me botimin në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Në supozimin që projektvendimi i propozuar do të miratohet nga Këshilli, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka përgatitur dhe projektvendimin “Për miratimin e listës së gjyqtarëve që do të caktohen për të gjykuar çështje gjyqësore urgjente në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kurbin”, sipas të cilit, për çdo periudhë dyditore deri më datë 30.09.2020, mbi bazën e shortit, do të përcaktohet një gjyqtar nga Gjykatat e Rretheve Gjyqësore Tiranë (Seksioni Penal), nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë. Në këtë rast do duhet të përjashtohen nga shorti vetëm drejtuesit e këtyre gjykatave. Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Faleminderit, zoti Toska!

Atëherë, jemi dakord me propozimin e bërë nga Komisioni?

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Dakord.

**Ilir Toska:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Alban Toro:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli miratoi projektvendimin sipas propozimit të bërë nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Kalojmë tek projekt-akti tjetër.

Prapë sërish fjalën ia jap zotit Toska.

***Ilir Toska:*** Faleminderit!

Në kushtet kur Këshilli miratoi projektvendimin e parë, do duhet të procedojmë me miratimin e vendimit të dytë, që ka të bëjë me listën.

Sa i përket listës, do duhet të organizojmë një short. Në short do të përfshijmë gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë (Seksioni Penal), që janë këta gjyqtarë: {...} – {...}; Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë, emrat e gjyqtarëve janë: {...} – {...}; ndërsa të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë janë: {...} – {...}.

Shortin do ta keni “online” të filmuar.

Tani Valbona do të procedojë me hedhjen e gjyqtarëve në një enë, për të përzgjedhur pastaj sipas periudhave respektive emrat e gjyqtarëve, ndërkohë do të përjashtojmë gjatë procedurës së shortit çdo gjyqtar i cili mund të jetë ngarkuar për të njëjtën periudhë në gjykatën e vet (Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, Krujë apo Lezhë; pra që janë të gatshëm në gjykatat e veta).

Futen në enën e qelqit me radhë emrat e gjyqtarëve:

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë: {...} – {...};

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë: {...} – {...};

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë: {...} – {...};

Përzgjidhet gjyqtarja {...}.

***Ilir Toska:*** Për periudhën 11 dhe 12 shtator emri i përzgjedhur është {...}. Po verifikojmë listën nëse është në gatishmëri për këto data.

Jo, nuk është në gatishmëri. Kështu që kualifikohet të caktohet gjyqtare {...}.

Përzgjidhet gjyqtarja {...}.

***Ilir Toska:*** Gjyqtarja e dytë e përzgjedhur për datat 13 dhe 14 shtator është {...}. Duhet të verifikojmë gatishmërinë e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë.

Atëherë, rezulton që të jetë e gatshme në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë gjyqtarja {...} për periudhën 14-20. Kështu që do duhet ta rihedhim shortin për datën 13 dhe 14 shtator.

Përzgjidhet gjyqtari {...}.

**Ilir Toska:** Për datat 13 dhe 14 shtator shorti zgjedhi gjyqtarin {...}.

Verifikojmë listën.

Atëherë, datat 13 dhe 14 shtator caktohet gjyqtari {...}.

Përzgjidhet gjyqtari {...}.

**Ilir Toska:** Të verifikojmë gjyqtarin {...}.

Atëherë, nuk është në listën e gatishmërisë. Për datat 15 dhe 16 shtator caktohet gjyqtari {...}.

Përzgjidhet gjyqtarja {...}.

**Ilir Toska:** Për datat 17 dhe 18 shtator është zgjedhur gjyqtarja {...}. Është e gatshme në gjykatën e saj. Hedhim sërish shortin.

Përzgjidhet gjyqtari {...}.

**Ilir Toska:** Verifikojmë për gjyqtarin {...}.

Atëherë, për datat 17 dhe 18 shtator përzgjidhet gjyqtari {...}.

Përzgjidhet gjyqtarja {...}.

**Ilir Toska:** Është brenda periudhës së gatishmërisë në gjykatën e saj.

Rihidhe përsëri shortin.

Përzgjidhet gjyqtari {...}.

**Ilir Toska:** Është okej.

Atëherë për datat 19 dhe 20 shtator, gjyqtari që përzgjidhet nga shorti është {...}.

Përzgjidhet gjyqtari {...}

**Ilir Toska:** Atëherë është i vlefshëm të përzgjidhet gjyqtari {...} për datat 21 dhe 22 shtator.

Përzgjidhet gjyqtarja {...}.

**Ilir Toska:** Është okej.

Përzgjidhet gjyqtarja {...}, se nuk korrespondon në listën e gatishmërisë në gjykatën e vet, pra për datat 23 dhe 24 shtator është përzgjedhur gjyqtarja {...}.

Përzgjidhet gjyqtari {...}.

**Ilir Toska:** Është okej. Nuk është tek lista e gatishmërisë në gjykatën e vet. Pra për datat 25 dhe 26 shtator gjyqtari është {...}.

Përzgjidhet gjyqtari {...}.

**Ilir Toska:** Nuk është në listën e gatishmërisë për këto data gjyqtari {...} në gjykatën e vet. Atëherë caktohet për datat 27 dhe 28 shtator gjyqtari {...}.

Përzgjidhet gjyqtarja {...}.

**Ilir Toska:** Është okej përzgjedhja e gjyqtares {...} për datat 29 dhe 30 shtator. Me kaq mbyllet shorti.

Mund t'ua them rezultatet e shortit:

Për datat 11 dhe 12 shtator 2020, gjyqtarja e përzgjedhur është {...} e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Për datat 13 dhe 14 shtator 2020, gjyqtari i përzgjedhur është {...} i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Për datat 15 dhe 16 shtator 2020, gjyqtari i përzgjedhur është {...} i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Për datat 17 dhe 18 shtator 2020, gjyqtari i përzgjedhur është {...} i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Për datat 19 dhe 20 shtator 2020, gjyqtari i përzgjedhur është {...} i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë.

Për datat 21 dhe 22 shtator 2020, gjyqtari i përzgjedhur është {...} i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Për datat 23 dhe 24 shtator 2020, gjyqtarja e përzgjedhur është {...} e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë.



Për datat 25 dhe 26 shtator 2020, gjyqtari i përzgjedhur është {...} i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Për datat 27 dhe 28 shtator 2020, gjyqtari i përzgjedhur është {...} i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Për datat 29 dhe 30 shtator 2020, gjyqtarja e përzgjedhur është {...} e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

**Naureda Llagami:** Faleminderit, zoti Toska!

Atëherë, kalojmë në votimin e projekt-aktit?

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ilir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi miratimin e listës së gjyqtarëve të Gjykatave të Rretheve Gjyqësore Tiranë (Seksioni Penal), Krujë dhe Lezhë, që caktohen për gjykuar, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kurbin, çështjet gjyqësore urgjente, në lëndë penale dhe civile, të regjistruara për periudhën deri më datë 30.09.2020, si më poshtë:

1. Për çështjet e regjistruara në datat 11 dhe 12 shtator 2020 – gjyqtarja {...};
2. Për çështjet e regjistruara në datat 13 dhe 14 shtator 2020 - gjyqtari {...};
3. Për çështjet e regjistruara në datat 15 dhe 16 shtator 2020 - gjyqtari {...};
4. Për çështjet e regjistruara në datat 17 dhe 18 shtator 2020 - gjyqtari {...};
5. Për çështjet e regjistruara në datat 19 dhe 20 shtator 2020 – gjyqtari {...};
6. Për çështjet e regjistruara në datat 21 dhe 22 shtator 2020 – gjyqtari {...};
7. Për çështjet e regjistruara në datat 23 dhe 24 shtator 2020 – gjyqtarja {...};

8. Për çështjet e regjistruara në datat 25 dhe 26 shtator 2020 - gjyqtari {...};
9. Për çështjet e regjistruara në datat 27 dhe 28 shtator 2020 - gjyqtari {...};
10. Për çështjet e regjistruara në datat 29 dhe 30 shtator 2020 – gjyqtarja {...}.

2. Ky vendim i njoftohet gjyqtarëve të caktuar sipas pikës 1, si dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Me kaq po e mbyllim edhe mbledhjen për sot. Kalofshi mirë!

\* \* \*

(Mbledhja deklarohet e mbyllur)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**